



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____ /2020

**“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, “KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 dhe 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e grupei deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË¹
VENDOSI:**

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Neni 130/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 130/a

Dhuna në familje

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, seksuale, psiko emocionale, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e

veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt ose në lidhje apo ish - lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim një deri në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga dy deri në 10 vjet burgim.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Q. Bushka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.01.2020

Lënda: Nismë ligjore për amendimin e ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Drejtuar: **Z. Gramoz RUÇI**
KRYETAR I KUVENDIT

KËTU

Inderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës, dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendi të Kuvendit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, projektligjin "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Bashkëlidhur lutem gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionit shoqërues.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DEPUTETËT

KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)

Klotilda Bushka

EGLANTINA GJERMENI

Egjantina Gjermeni